



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1234/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka, (SLS) paraqitur për shkak të parregullsive lidhur me votat përmes postës për komunën e Istogut për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik SLS në të cilën theksohet se në votimin në Serbi të organizuar nga komisariati për refugjat votuesit kanë votuar publikisht para zyrtarit të komisariatit për personat e zhvendosur dhe aty i kane dorëzuar fletëvotimet e tyre dhe se nuk kanë parë asnjë lloj kuvertash ku ata do ti futnin fletëvotimet e tyre, ndërsa ne pyetjen e tyre pra të votuesve se a është kjo e tëra zyrtarët iu përgjigjeshin se të tjerat do ti kryejnë ata vet. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime i kane parë personalisht duke shkuar vet në vendngjarje që të binden ku nga afër kanë parë anëtarët e gusht të familjeve të tyre duke votuar në këtë mënyrë. Parashtruesi i ankesës thekson se kanë qenë prezent kur kanë votuar më shumë se 150 votues të cilët kanë shënuar listën e tyre në fletëvotim dhe fletëvotimin e tyre e kanë dorëzuar tek zyrtarët, mirëpo në bazë të rezultateve përfundimtare del se i kanë fituar vetëm 20 vota. Andaj me këtë rast pala ankuese thekson se ky rezultat është totalisht i palogjikshëm pasi që në komunën e Istogut kanë fituar me shumicë absolute nga komuniteti serb, ndërsa nga votat nga Sërbia nuk kanë fituar asgjë dhe se ky votim nga Serbia është kryer në kundërshtim me të gjitha rregullat e procesit zgjedhor pasi që fletëvotimet nuk janë dërguar me postë nga ana e vet votuesve, por zyrtaret e komisariatit për refugjat kanë votuar vet në këto fletëvotime duke i dorëzuar vetë ato me çka edhe kanë ndryshuar vullnetin e zgjedhor të votuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë dëshmi bindëse që do ti bënte të besueshme dhe që do ti vërtetonte pretendimet e tilla ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1234/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.